

# KARTËMONEDHA 1000 LEKË

## KONTROLLO VËRTETËSINË E KARTËMONEDHËS

### PREK

Kjo kartëmonedhë është shtypur në letër prej pambuku dhe karakterizohet nga një tingëllim e konsistencë e veçantë.


- 1 Ndieje shtypin e ngritur te vlera nominale, tekstet dhe portreti. Ndiej vijat e shkurtra përgjatë anës së majtë dhe të djathtë të kartëmonedhës, që përbëjnë elementin e njohjes nga personat me aftësi të kufizuara shikimi.

### SHIKO

- 2 Portreti i Pjetër Bogdanit, vlera nominale 1000 Lekë dhe simboli i stilizuar i shqiponjës bëhen të dukshme, kundrejt dritës.
- 3 Nga një shirit i ndërprerë, filli i sigurisë duket një vijë e errët e pandërprerë.

### LËVIZ

- 4 Simboli i diellit në cepin e sipërm djathtas ndryshon ngjyrë, nga e artë në të gjelbër, me një efekt dinamik sipas këndit të lëvizjes.
- 5 Filli i sigurisë ndryshon ngjyrë nga e gjelbër në të purpurt.
- 6 Në faqen e pasme të kartëmonedhës, shiriti i shndritshëm në zonën qendrore shfaq të shkruar vlerën 1000 Lekë.



## KARTËMONEDHA JONË E RE: E SIGURT DHE MODERNE

Banka e Shqipërisë vijon ta plotësojë serinë e re të kartëmonedhave shqiptare, me emetimin e prerjeve të reja me pamje e cilësi të përmirësuar, për t'iu përshtatur zhvillimeve të teknologjisë, duke i bërë ato më të sigurt dhe të besueshme për publikun.

Kartëmonedhat ekzistuese do të vijojnë të përdoren si mjet pagese bashkë me kartëmonedhat e reja.



Për më shumë informacion, vizito [www.bankofalbania.org](http://www.bankofalbania.org)